



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:230921
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05585716

C-IV.-13-2792

Ankuesi:

A S nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Amortizatorët”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.11 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN047-0224 i dt.09 tetor 2013.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.01 nëntor 2013, ankuesi ish punëtor i NSH “Amortizatorët” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN047-0224 i dt.09 tetor 2013, me të cilin ka kërkuar anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuara nga pagesa e qirasë së ambienteve të NSH-së, me kompensim në shumë shtesë prej 2,941.00€. Ankuesi ka theksuar se AL-ja ia ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se kërkuesi ka pas të drejtë të ushtroj ankesë ndaj shumës së përfituar te organet e kompetente. I njëjti me rastin e paraqitjes së ankesës në AL, ka shtuar se i ka deponuar të gjitha provat që sipas tij vërtetojnë se i ka ushtruar të gjitha mjetet juridike me rastin e ndarjes jo proporcionale të të hyrave. Ka shtuar se shume nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë mes të punësuarve. Menaxhmenti i NSH-së para

shpërndarjes nuk i ka përcaktuar kriteret e ndarjes së mjeteve, por ka vendosur në mënyrë arbitrare. Bashkangjitur ankesës ka dorëzuar Kopjen e kundërshtuar të vendimit të AL.

Me dt.26 shkurt 2024 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit për shkak se AL i ka vërtetuar saktësisht rrethanat faktike dhe vendimi është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, andaj edhe ankesa e të njëjtit është e pa bazuar. Ka shtuar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Parashtruesi nuk ka paraqitur ankesë tek autoritetet kompetente për të kundërshtuar vendimin e Komisionit të Shpërndarjes. Ai përfitoj një shumë të caktuar bazuar në vendimin për shpërndarje brenda afatit prej 15 ditësh. Ai nuk e arsyetoj shkakun se pse nuk ka mundur që ta kundërshtoj këtë vendim. Pala kundërshtare i përmbahet qëndrimit se nuk ka autoritet për ta anuluar atë vendim. Në kompetencat e AL, nuk përfshihet anulimi i vendimeve të menaxhmetit të NSH-së. Andaj ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar. Mbrojtjes i ka bashkangjitur: Raportin e Komisionit për Shpërndarjen e Mjeteve të Inkasuara nga Qiraja e UNMIK-ut, punonjësve të NSH “Fabrika e Amortizatorëve” – Prishtinë, Vendimi nr.91/2 dt.05.04.2011, Ekstrat procesverbali nr.36/1 dt.21.02.2011.

Me dt.27 shkurt 2018, ankuesi ka paraqitur Përgjigje në mbrojtjen e palës kundërshtare ku ka theksuar se objekt i padisë janë të hyrat nga qiraja dhe jo nga marrëdhënia e punës. NSH-ja kishte inkasuar shumën prej 2.537.000€ neto në emër të qiradhënies së objekteve afariste. Komisioni i NSH-së kishte përpiluar raportin nr.333/1 dt.04.11.2010 për shpërndarjen e këtyre mjeteve, dhe shpërndarja është bërë 85% punëtorëve aktiv dhe 15% punëtorëve pasiv, dhe se vendimi është shpallur në tabelën e shpalljeve dhe ia ka shkelur të drejtën në ankesë. Ankuesi kishte kontratë pune me NSH-në dhe kërkesa e tij është ligjore.

E paditura ka paraqitur kundërpërgjigjen e saj me dt.14 mars 2018 ku ka theksuar se shprehimisht e kundërshton si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar duke theksuar rregullin bazik se në procedurë kontestimore pala kërkuese e ka barrën e provës. Të ardhurat nga qiraja i takojnë pronarit legjitim pra NSH-së, ndërsa punëtorëve u takojnë pagat për punët e kryera. Pra, ankuesi nuk është pronar – aksionar i NSH-së për të pretenduar shpërndarjen e të ardhurave nga qiraja. I njëjti e pranon edhe vet se ka qenë punëtor pasiv, pra nuk ka ofruar punë për NSH-në dhe mbeti pran propozimit në mbrojtje që gjykata ka refuzoj ankesën e ankuesit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dëshmojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se duhet të bëhet anulimi i vendimit për shpërndarjen e të ardhurave nga qiraja e NSH-së. Ankuesi së bashku me ankesë ka bërë dorëzimin e vetëm të kopjes së kundërshtuar të vendimit të AL. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të përgjigjes në mbrojtjen e të paditurës. Gjithashtu gjykata ia ka dorëzuar të njëjtit edhe kundërpërgjigjen e të paditurës, ku ka mundur që të paraqes përsëri prova shtesë. Kurse e paditura i ka paraqitur këto prova: Raportin e Komisionit për Shpërndarjen e Mjeteve të Inkasuara nga Qiraja e UNMIK-ut, punonjësve të NSH “Fabrika e Amortizatorëve” – Prishtinë, Vendimi nr.91/2 dt.05.04.2011, Ekstrat procesverbali nr.36/1 dt.21.02.2011, përmes të cilave i ka mbështetur pretendimet e saj.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se nuk i është bërë shpërndarja ashtu siç do të duhej të bëhej, se të njëjtit i takon shuma më e lartëcekur, si dhe të dëshmonte se e ka kundërshtuar vendimin për shpërndarje. Gjukata gjen se, në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në anulimin e vendimit për shpërndarjen e të ardhurave nga qiraja, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Ankuesi ka bërë vetëm dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar. Andaj, gjykata nuk mund ta marr si provë të pranueshme dhe të vetme për të ardhur në përfundim se ankuesit i takon e drejta e pretenduar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën me dt.20 dhjetor 2019.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Hajrie Shala